




2-060/7206

19 08 2022



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës së Junikut;
Komiteti për Politikë dhe Financa;
Numër: 02-07/22;
Datë: 29.08.2022 .

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa iu bënë këtë:

FTESË

Për: anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Nga: Shpejtim Gacaferi – kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa;
Lënda: mbledhja e shtatë (2022) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Vendi: sala e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 26.08.2022, ora 10⁰⁰.

Sm


Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i kërkesës për Nxerrjen e propozim – Vendimit për shpalljen e ngastrave kadastrale Interes i përgjithshëm publik i Komunës së Junikut;
3. Informatë mbi mbarëvajtjen e procesit të korrje-shirjeve në komunën e Junikut;
4. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2022/25 të Ministrisë së Financave;
5. Themelimi i Komisionit për Emërtimin e Zonave të Qarkullimit Publik;
6. Informatë lidhur me përgatitjet për vitin e ri shkollor 2022/2023;
7. Kërkesë për rishqyrtim dhe anulim të Vendimit Nr. 02/17/22 i miratuar në Kuvend me dt: 29/06/22;
8. Shqyrtimi i kërkesës për nxjerrjen e Vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në teritorin e Komunës së Junikut;
9. Të ndryshme,

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 799 100

<http://rk-rks-gov.net/junik>



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

KOMITETI PER POLITIKË DHE FINANCA

Kuvendi Komunal-Junik

Nr. 02-06/22

Datë: 26. 07. 2022, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen e Gjashtë të Rregullt të Komitetit për Politike dhe Financa në Junik, të mbajtur më datë 26 Korrik, 2022, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Shpejtim Gacaferi, kryesues (LDK),
2. Ermelinda Lolluni, përfaqësuese (LDK),
3. Rajmonda Krasniqi, përfaqësuese (AAK),
4. Xhemë Tofaj, përfaqësues (LVV), dhe
5. Dervish Bajraktari, përfaqësues (AAK).

Poashtu të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe drejtoresha për Buxhet dhe Financa znjsh. Vjollca Qestaj dhe zyrtari Kryesor Financiar z. Arten Hamza.

Mbledhjen e Gjashtë të Rregullt të Komitetit për Politike dhe Financa e shpalli të hapur kryesuesi i këtij Komiteti, z. Shpejtim Gacaferi, i cili paraqiti dhe kërkoi miratimin e Rendin e Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Raportimi i Kryetarit të Komunës së Junikut për periudhën Janar-Qershor 2022,
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Jashtëm për vitin 2021, dhe Plani i veprimeve për zbatimin e rekomandimeve,

çështje që janë më evidente, të cilat duhet të raportohen. Ky raport është dërguar me datën 21. 06. 2022, ku sa i përket çështjes së opinionit kemi opinionin e pamodifikuar që është një opinion më i lartë që kanë pasqyrat financiare. Do të thotë se pasqyrat financiare të prezantuara për 2021 pasqyrojnë një gjendje të drejtë, ku janë të prezantuara të gjitha shpenzimet, obligimet dhe procedurat tjera.

Si përfundim, opinionin është i pamodifikuar që nuk na sanksionon për aplikim në fonde të ndryshme dhe organizata tjera.

Gjatë punës ka pasur të gjetura të ndryshme dhe gjithsej për vitin e kaluar kemi katër të gjetura. Tri janë të gjetura në vazhdimësi sikurse në vitet paraprake, ndërsa një është e gjetur e re në vitin 2021.

Çështja e parë është nënshkrimi i kontratës përtej vlerës së parashikuar të buxhetit. Ato janë projekti i asfaltimit të rrugës lokale Junik-Jasiq, ku është vërejtur se vlera buxhetore ka qenë 135,000.00 E, ndërsa kontrata është nënshkruar për 145,651.00 E. Pastaj, bashkëpunimi me Ministrinë e Ekonomisë, ndërtimi i ujësjellësi në lagjen 'Agim Ramadani', që është pa mjete financiare, gjithashtu kontratën për ndërtimin e memorialit 'Dëshmorët e UCK-së', dhe kontrata për ndërtimin e Parkut të Fëmijëve, që ka qenë e paraparë në financim me MAPL.

Pra, të gjitha këto kontrata janë të nënshkruara pa mjete financiare që Komuna nuk ka pas mjete për zbatimin e tyre.

Është cekur që në këto katër projekte të lartpërmendura është vërejtur që Zyrtares Kryesor Financiar nuk e ka nënshkruar deklaratën për disponueshmëri të mjeteve, mirëpo ato janë nënshkruar nga persona tjerë, pra, kjo është çështja.

E dyta, është zotimi dhe urdhër-blerja me vonesë. Kjo ka qenë e bartur edhe nga vitet e kaluar, ku sipas rregullave financiare përcaktohen hapat për procedim të pagesave, ku fillimisht duhet të bëhen kërkesat për blerje dhe zotim, të procedohet me urdhër-blerje, pasta pranimi i mallit, dhe pas pranimi të faturës ekzekutohet pagesa.

Çështja e tretë është me rëndësi në regjistrat e pasurisë, është njëjtë edhe me vitin e kaluar, mirëpo këtë vit gjendja është pak më e mira, për shkak se vitin e kaluar kemi pasur modifikim të raportit, pra opinionin e kemi pasur të kualifikuar shkak i pasurisë. Këtë vit është pak më mirë, të pasuria mbi 1000.00 E gjendja është më e mirë. Janë të regjistruara të gjitha pasuritë mbi 1000.00 E, por të ato nën 1000.00 E kemi mungesë të një zyrtari dhe shkak i mos funksionimi të sistemit të E-pasurisë.

Përndryshe, pasuria nën 1000.00 E nuk është regjistruar në sistemin e E-pasurisë, por janë të regjistruara vetëm si evidencë.

Dhe, një rekomandim i ri që është dhënë për vitin 2022 është dobësia në raportimin e detyrimeve, ku sipas rregullave financiare ne jemi të obliguar që të raportojmë çdo muaj për faruat e papaguara dhe obligimet që i kemi në Ministrinë e Financave. Prapë ne e kemi përmbush afatin e deklarimit mujor, mirëpo gjatë testimit është vërejtur që nuk janë raportuar si obligim shkak se ajo faturë është paguar në fund të muajit, dhe sipas këshillave të tyre duhet të raportohet si obligimi muajit të kaluar. Mirëpo, ne për këtë nuk jemi pajtuar dhe u kemi dhënë sqarime, dhe që është e prezantuar edhe në raport, e cila është e cekur në faqen nr. 18-të të këtij raporti.

përgatitur në katërmbëdhjetë programe ekonomike buxhetore, duke filluar nga Zyra e Kryetarit, duke përfshirë të gjitha drejtoritë dhe Zyrën Komunale për Komitete. Buxheti i miratuar nga Asambleja Komunale për vitin 2022 është në vlerë prej 1,658,591.00 E. Që nga periudha Janar-Qershor ka pësuar ndryshime për të hyrat nga donacionet dhe donacionet e bartura në vlerë prej 2469.58 E. Bartja e të hyrave të pashpenzuara për 2021 për shpenzim në 2022 është në vlerë prej 91,915.99 E, dhe nga niveli qendror është rritur kategoria e pagave në shumën prej 9,928.36 E, kjo për mbulimin e shtesave për përfituesit nga Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike për punëtorët shëndetësorë të QKMF-së. Pra, buxheti përfundimtar duke përfshirë donacionet për vitin 2022 është në vlerë prej 1,762,905.20 E.

Në vazhdimi drejtoresha Vjollca Qestaj për të pranishmit në këtë mbledhje shpjegoi Raportin e ekzekutimit të buxheti, të hyrat buxhetore për vitin 2022, të hyrat periodike nga granti i qeverisë, të hyrat vetanake periodike për vitin 2022, të hyrat vetanake kryesore periodike nëpër kategori për Janar-Qershor 2022, shpenzimet buxhetore për vitin 2022, raportin detal të shpenzimeve në paga, mallra dhe shërbime sipas drejtorive, shpenzimet analitike të komunalive, subvencioneve dhe investimeve kapitale, shpenzimet sipas drejtorive dhe progresi me periudhën e njëjtë të viteve paraprake, progresi i shpenzimeve kapitale sipas projekteve për vitin 2022, dhe pasqyrën e obligimeve të papaguara për periudhën Janar-Qershor 2022.

Pika e Pestë,


Themelimi i Panelit Përzgjedhës të anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Kryesuesi z. Shpejtim Gacaferi tha, ne në mbledhjen e fundit të Kuvendit Komunal, të mbajtur me 29. 06. 2022 kemi nxjerr një propozim-vendim për themelimin e këtij Komiteti Konsultativ, dhe kemi caktuar ‘çelësin’ që tri subjektet politike të përfaqësojnë në Kuvend me nga një anëtar, një nga ekzekutivi dhe një nga OJQ-të, kjo sipas udhëzimit administrativ. Emrat do të përzgjidhen në mbledhjen e Kuvendit, me qëllim që të kompletohet ky panel përzgjedhës për Komitetin Konsultativ.

Pika e Gjashtë, Të ndryshme.

Z. Xhemë Tofaj pyeti për vendimin për subvencionimin për studentët, dhe pyeti se ku është arsyetimi i mosmiratimit të këtij vendimi, ndërsa tha përgjigjen do ta kërkoj edhe me shkrim në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal?!

Z. Dervish Bajraktari tha, premtimi ka qenë se deri në fund të korrikut 2022 të kryhen këto pagesa.



06-180-7166
19 08 2022

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Nr.
DATE:	19.08.2022
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/OD/FROM:	z.Zenun Shala – Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për propozim Vendim

Bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040), neni 42, pika-j) të Statutit të Komunës së Junikut, (Nr. 001/3127, të datës: 29.9.2010), neni 38 paragrafi 1) i Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Junikut, ju bëjmë këtë:

KËRKESË

Që të vendosni në rendin e ditës në mbledhjen e radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit Komunal kërkesën për:

Shpalljen e ngastrave kadastrale me numër: P-73105038-00470-0, P-73105038-00471-0, P-73105038-00473-0, P-73105038-00474-0 dhe P-73105038-00475-0 Zona kadastrale Junik interes i përgjithshëm publik.

P.S Propozim – Vendimi për shpalljen e parcelave kadastrale të lartëcekura interes përgjithshëm publik i Komunës së Junikut

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d), nenit 17 paragrafi a) dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr. 03/L-040); nenit 10 paragrafi a) dhe b) si dhe nenit 22 paragrafi 4) i Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.201, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis propozon këtë:

Propozim VENDIM

Për

SHPALLJEN E PARCELAVE KADASTRALE NUMËR : P-73105038-00470-0, P-73105038-00471-0, P-73105038-00473-0, P-73105038-00474-0 dhe P-73105038-00475-0 INTERES PUBLIK I KOMUNËS SË JUNIKUT

- I. Me këtë propozim Vendim shpallen interes publik i Komunës së Junikut parcelat numër: P-73105038-00470-0, P-73105038-00471-0, P-73105038-00473-0, P-73105038-00474-0 dhe P-73105038-00475-0 Zona kadastrale Junik.
- II. Objekt i shpalljes interes i përgjithshëm publik janë pronat e paluajtshme të cekura në pikën I. të këtij propozim vendimi në sipërfaqe të përgjithshme prej 61812 m², ku të njëjtat evidentohen në emër të P.Sh.Ereniku Gjakovë.
- III. Komuna e Junikut do të kompenzon shumën prej 20% të vlerës së pronës së likuiduar. Shuma prej 20 % do t'ju kompenzohet punëtorëve të ish-Ndërmarrjes Shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Komuna e Junikut, ka nevojë të theksuar për prona, të cilat do t'i mundësonin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik social. Si pasojë e mungesës së pronave publike komuna në shumë raste nuk ka mundësi implementimi të projekteve të karakterit zhvillimor. Komuna e Junikut është në procesin e Rishikimit të Planit Zhvillimor Komunal, në të cilën planifikon që parcelat e cekura më lartë t'i përfshijë si Lokacion të destinuar për zhvillimi ekonomik lokal, respektivisht, **“Inkubator Biznesi dhe Zonë për zhvillim ekonomik”**.

Parcelat për të cilat propozojme të shpallen interes i përgjithshëm publik ishin në listën e shitjes së Aseteve 56 (SHAL 56) nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Me kërkesën e Kryetarit të Komunës së Junikut numër 1-180-4484 datë 09.06.2022, të njëjtat largohen nga lista e shitjes së Aseteve 56 (SHAL 56) nga ana e AKP.

Komuna njoftohet nga AKP-ja me : Njoftim lidhur me largimin e asetit nga Shitja e Aseteve 56 (SHAL 56) përmes likudimit PE-029, ref.nr.1427-2022 datë 26 korrik 2022.

Nga AKP-ja kërkohet që në afatin 2 mujor nga vendimi i bordit për largim nga shitja, Komuna e Junikut duhet të njoftoj të njëjtën, që Asambleja ka marrë vendim për shpalljen zonë të interesit asetin në fjalë.

Presim që në afat sa më të shkurtër do ta shqyrtoni dhe aprovoni propozimin tonë.

Këtij akti i bashkangjesim:

1. Vendimi e bordit të AKP-së
2. Njoftimi lidhur me largimin e asetit nga shitja



26 korrik 2022

Për: Z. Ruzhdi Shehu
Kryetar i Komunës së Junikut
51050, Junik

NSH, DP, SOE
1627-2622
2 27-02-2022

Lënda: Njoftim lidhur largimin e asetit nga Shitja e Aseteve 56 (SHAL 56) përmes likuidimit

I nderuari Z. Shehu,

Duke iu referuar kërkesës tuaj të pranuar me numër protokoli 1925 të regjistruar në Zyrën Qendrore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përmes së cilës keni kërkuar largimin nga SHAL 56, të asetit si në vijim:

- Njësia nr.15 NSH Ereniku - Prodhimtaria Primare – Toka në Junik

Agjencia Kosovare e Privatizimit ju njofton se ka shqyrtuar kërkesën tuaj, dhe ju informon se aseti i përmendur më lartë është larguar nga SHAL 56 me vendim të Bordit të Drejtorëve me numër Ref.BD 166-1.

Po ashtu brenda **afatit 2 muor** nga data e vendimit të Bordit për largim nga shitja, Komuna e Junikut duhet të njoftoj AKP-në, që Asambleja Komunale ka marrë vendim për shpalljen e zonës si interes të përgjithshëm publik dhe se ka dorëzuar kërkesën në Ministrinë përkatëse për të iniciuar procedurat për shpronësimin e këtyre asetëve.

Agjencia Kosovare e Privatizimit po ashtu ju njofton se nga data e pranimi të kësaj shkrese nga data e vendimit të Bordit për largim nga shitja deri në një **periudhë 6 mujore**, në rast se nuk nxjerrët vendimi preliminar i shpronësimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, atëherë këto asete do të rivendosen në procedurat e tenderimit publik.

Këto afate janë vendosur për t'i mundësuar komunës tuaj dhe Qeverisë që të zbatojnë procedurat ligjore për të mundësuar transferin e asetëve për shfrytëzim në interes publik. Në rast se komuna nuk ndërmer veprimet ligjore të lartcekura brenda këtyre afateve, AKP, sipas ligjit dhe planit të saj të punës do të jetë e detyruar t'i publikoj këto asete në pronësi shoqërore për shitje.

Pavarësisht kësaj, kërkojmë nga Komuna e Junikut që në asnjë rrethanë të mos ndërmerre çfarëdo veprimi në rrënimin apo demolimin e asetëve deri në përfundimin eventual të procedurave të shpronësimit dhe dorëzimit eventual të asetit tek komuna, në të kundërtën AKP do të jetë e detyruar të ndërmerre veprime ligjore ndaj komunës, dhe personave përgjegjës për dëmtimin eventual të pronës shoqërore.

1 / 2



Duke ju shprehur konsideratat e mia personale, shpreh gatishmëri për takim ose bisedë të drejtpërdrejtë në rast se keni ndonjë paqartësi lidhur me këtë njoftim.

Gjithashtu, në emër të AKP-së falënderoj Komunën e Junikut për bashkëpunim gjatë procesit të privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. AKP çmon lartë vazhdimësinë dhe ngritjen e këtij bashkëpunimi.

Me nderime,


Arçila Lokaj
Menaxher e Zyres Ragonale, Pejë
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

IP-100-10-1002

Në bazë të nenit 14.10 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-073, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesja e Bordit duke ushtruar kompetencat e tyre emergjente konform nenit 12.1 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me datën 23 qershor 2022, marrin vendimin e mëposhtëm emergjent.

Ky vendim emergjent merret duke pasur parasysh natyrën e urgjencës objektive për të cilën nuk ka qenë e mundur të vendoset në një mbledhje të zakonshme të Bordit, apo duke shfrytëzuar procedurën e vendosjes sipas nenit 9.5 të Statutit të Bordit, dhe ky vendim i nënshkruhet ratifikimit të Bordit në takimin e radhës.

Fundaj, kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi duke vepruar së bashku marrin vendimin si më poshtë:

VENDIM

- I. Aprovohet tërheqja e aseteve sipas listës së bashkangjitur nga SHAL 56;
- II. Menaxhmenti udhëzohet të njoftojë Komunitet se brenda 60 ditëve nga pranimi i njoftimit nga AKP, Komuna duhet të njoftojë AKP-në që Asambleja Komunale ka marrë vendim për shpalljen e zonës së interesit të përgjithshëm publik dhe ka dorëzuar kërkesën në ministrinë përkatëse për inicim të procedurave të shpronësimit të këtyre aseteve. Po ashtu, Komunitet të njoftohen se nga data e njoftimit nga AKP deri në një periudhë gjashtë (6) muajore në rast se nuk nxjerret vendimi preliminar për shpronësim nga qeveria, atëherë këtu asete do të rivendosen në procedurat e tenderimit publik.
- III. Ky vendim do të hyjë në fuqi ditën e aprovimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Zëvendës Kryesues së Bordit të Drejtorëve.

Kopja e këtij vendimi i dërgohet anëtarëve të Bordit menjëherë pas nënshkrimit.

Bashkangjitur me këtë vendim është memorandum i paraqitur nga Menaxhmenti i Agjencisë në bazë të cilave informata dhe rekomandime është marrë vendimi dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Prishtinë, 23 /06/2022

Nazmi Mikullovci

Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Syzana Dautaj-Surdulli

Zëvendës Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA-KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA-KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
Nr./No. 2-155/2080
NË ORIN 8
NË NËN 1
DATE 17-08-2022

DATE/A:	17.08.2022
PËR/ZA/TO:	Shpejtim Gacaferi– Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe të Kuvendit Komunal informatën rreth Qarkorës Buxhetore 2023/02

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nr: 03/L-048 neni 20, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr: 03/L-040 neni 40 alinea 40.2 pika nën b), si dhe duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2023/02 për Komunitat të nisur nga Ministria e Financave, kërkojmë nga ju që të shtohet në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe të Kuvendit Komunal informata rreth Qarkorës Buxhetore 2023/02.

Sqarim:

Kjo kërkesë vjen me vonesë për arsye se edhe ne si Drejtori e Financave nuk e kemi pranuar me kohë informatën dhe materialin rreth Qarkorës Buxhetore 2023/02.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK



2-155/2067
17.08.2022

DATE/A:	17.08.2022
PËR/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës Kryesuesin e Kuvendit Drejtoret e Drejtorive Komunale
NGA/OD/FROM:	Vjollca Qestaj Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM

Të nderuar!

Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr 03/L-048, neni 60, Ligjin për Vetëqeverisje lokale (Ligji Nr:03/ L-040) dhe Statutin e Komunës, pas pranimit të Qarkores Buxhetore 2023/02 në formë elektronike nga Ministria e Financave me datë 17.08.2022. Komuna ka për obligim fillimin e Procedurave të planifikimit të Buxhetit për periudhën 2023-2025 në përputhje me limitet buxhetore të përcaktuara në KASH-in (Korniza Afatmesme e Shpenzimeve) për Komunat.

Përmes këtij njoftimi keni obligim që të hartoni planifikimet për Programin tuaj përkatës dhe ti dorëzoni në email apo edhe fizike tek drejtoria për Buxhet dhe Financa deri me datë **25.08.2022**.

Në formë elektronike do ti keni të bashkangjitura Qarkoren Buxhetore komunale 2023/02 nga Ministria e Financave, KAB-in 2023/2025 e miratuar në Qershor 2022 dhe Qarkoren e brendshme komunale #2023/02.

Me Respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK



	QARKORE E BRENDSHME BUXHETORE KOMUNALE #2023/02
Për:	Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit, Të gjithë Drejtorët e Drejtorive (Programeve Buxhetore) të KK-Junik
Nga:	Vjollca Qestaj- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
Data:	17.08.2021
Lënda:	Përgatitja e materialeve buxhetore - Propozim Buxhetit Komunal sipas Drejtorive (Programeve Buxhetore) për periudhën 2023-2025, sipas Qarkores Buxhetore nr. 2023/02 për Komuna.

Kjo Qarkore e brendshme komunale #2023/02 do të ju ofroj udhëzime për përgatitjen e Propozim Buxhetit për Drejtorinë komunale, pasi që na nevojiten informatat për hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2023/2025. Me Qarkoren Buxhetore 2023/02 për Komunitat dërguar nga Ministria e Financave, ju njoftojmë për zhvillimin e procesit buxhetor komunal në pajtim me procedurat dhe kalendarin e përcaktuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Komisioni i Grandëve pranë MF-it ka aprovuar grandet qeveritare për financimin komunal në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet:2023-2025, si dhe parimet, kriteret dhe formulat e përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, andaj referojuni asaj qarkoreje si dhe KASH-it të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

1. Kërkojmë nga të gjithë Drejtorët e Drejtorive (Programeve) buxhetore që deri me datë: 25.08.2022 në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa të paraqesin Kërkesat e tyre buxhetore për vitet: 2023-2025, konform limiteve të Qarkores Buxhetore nr.2023/02, për të gjitha kategoritë buxhetore të shpenzimeve siç janë: Paga&Mëditjet, Mallra dhe shërbime, Shpenzimet komunale, Subvencionet dhe Transferet si dhe Shpenzimet kapitale, (Të ndryshohen projektet nëse është nevojë sipas prioritetëve, të shtohen projektet nëse keni plane, duke ju referuar listës së projekteve 2022-2025 të bashkangjitur në email) si dhe Drejtoria që inkason të hyra të paraqes sa më real parashikimin e të hyrave vetanake.
2. Po ashtu duhet të paraqitni numrin e punëtorëve të Drejtorisë (Programit) tuaj buxhetor si dhe koeficientet e pagave (aktual) që ekzistojnë me Buxhetin e vitit 2022, meqenëse nuk ka lëvizje - rritje të numrit të punëtorëve për vitin fiskal 2023.
3. Kategoria ekonomike paga dhe mëditje për Komunën e Junikut për vitin 2023 sipas qarkores buxhetore 2023/02 është parashikuar të jetë 1,170,906.00€.
4. Kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime për komunën e Junikut për vitin 2023 sipas qarkores buxhetore 2023/02 është parashikuar të jetë 236,740.00€.
5. Kategoria ekonomike Shpenzime komunale për komunën e Junikut për vitin 2023 sipas qarkores buxhetore 2023/02 është parashikuar të jetë 37,700.00€.
6. Kategoria ekonomike Subvencione dhe transfere për komunën e Junikut për vitin 2023 sipas qarkores buxhetore 2023/02 është parashikuar të jetë 52,000.00€.
7. Kategoria ekonomike Shpenzime kapitale për Komunën e Junikut për vitin 2023 sipas qarkores buxhetore 2023/02 është parashikuar të jetë 380,000.00€.
8. Totali i buxhetit për komunën e Junikut për vitin 2023 sipas qarkores buxhetore 2023/02 është parashikuar të jetë 1,877,346.00€.
9. Për projeksionet e viteve 2024-2025 referojuni qarkores buxhetore 2023/02, dhe bëjeni parashikimin për KAB-in komunal sepse duhet të bëhet planifikimi për tri vite.

Bashkangjitur:

1. Qarkorja Buxhetore nr. 2023/02 për Komuna
2. KAB- i 2023/2025 i miratuar në Qershor 2022

Vërejtje:

Kërkesat buxhetore –Formularët nën A, dhe B dhe formulari nga USAID duhet të plotësohen nga ana e Drejtorëve të Drejtorive (Programeve buxhetore), të cilat i keni në posedim nga emaili i parë që ju është dërguar me qarkoren e I-rë buxhetore 2023/01.

Sqarime më të hollësishme rreth plotësimit të Kërkesave buxhetore- formularëve, mund të merren në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe nga zyrtari kryesor financiar Arten Hamza. Bashkangjitur në ANEKS keni edhe tabelat për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të cilat duhet të plotësohen në formularin A dhe të jenë pjesë e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2025.

ANEKS

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2022					
2023					
2024					
Planifikimi për 2025					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2022 Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore
Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

[Emri i Institucionit/Ministritë/Komunës: Emri i Shërbimit/Subvencionit].

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve gra	Numri i Përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2022						
2023						
2024						
Planifikimi për 2025						



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës së Junikut Shpejtim Gacaferri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Venera Çerkini, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 13.07.2022 -VI-020-624
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Leonora Bajrami, Zyrtare për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Junikut	
Lloji i aktit:	Vendim Nr.02/17/22 për miratimin e listës së pronave të propozuara për dhënie në shfrytëzim	

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues/e,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në mbështetje të nenit 30.2 të Ligjit Nr. 03/L-400 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshime plotësimin e Rregullores (QRK)nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 12.07.2022 ka pranuar për vlerësim të ligjshmërisë Vendimin Nr.02/17/22 për miratimin e listës së pronave të propozuara për dhënie në shfrytëzim të nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, kërkon:

Rishqyrtimin e Ligjshmërisë së Aktit

Vendim Nr.02/17/22 për miratimin e listës së pronave të propozuara për dhënien në shfrytëzim, *sepse* nuk është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2022, ka miratuar Vendimin Nr.02/17/22 për miratimin e listës së pronave të propozuara për dhënien në shfrytëzim.

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Junikut është në *kundërshtim* me Nenin 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ku parashihet se komuna duhet të publikojë listën e përgjithshme të pronave, si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri më 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Vendimi Nr.02/17/22 për miratimin e listës së pronave të propozuara për dhënien në shfrytëzim, është në kundërshtim edhe me shkresën të cilën Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me datë 13 janar 2022, e ka përcjellur në Komuna, e cila cakton afat shtesë deri më 31 mars 2022, për publikimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave, kjo për arsye të mbajtjes së zgjedhjeve, dhe çdo proces për dhënien e pronave në shfrytëzim, për pronat e pa publikuara pas këtij afati, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, vlerësohet jo legjitim.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Junikut që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



03-180-7167
19.08.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK



DATE/A:	19.08.2022
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal, Junik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik
NGA/OD/FROM:	znj.Leonora Shehu - Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Kërkesë për të shtuar në rend dite nxjerrjen e vendimit për fillimin e procedurave për plotësim-ndryshim të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut.



Të nderuar,

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika c), nenit 34 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane (U.A Nr.02/2019); nenit 15 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Junikut, Rregullores Nr.02/2021 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve komunale neni 14, si dhe Rregulloren e punës së Kuvendi Komunal Junik, kërkojmë që të nxirret vendimi për lejimin e fillimit të procedurave për plotësim-ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut.

Arsyetim:

Me Udhëzimin Administrativ Nr.02/2019, për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, në nenin 4 paragrafi 2, përcaktohet numri i këshillave lokale në bazë të numrit të banorëve të Komunës. Andaj, kërkojmë që t'a bëjmë plotësim-ndryshimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Junikut.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK

DATË/A:	18.08.2022
PËR/ZA/TO:	z.Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut
PËRMES/PREKTO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës së Junikut
NGA/ OD/FROM:	z.Besart Tofaj - Nënkyetar i Komunës së Junikut – Koordinator i Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
TEMA/ SUBJEKTA/ SUBJECT	Kërkesë

I nderuar,

Bazuar në nenin 9, pika 1.8 e Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03-2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut ju sjell informatën e parë - 2022, për Kuvendin Komunal në Junik.

Me respekt !

